

DEPARTAMENTI I EPIDEMIOLOGJISË DHE KONTROLLIT TË
SËMUNDJEVE INFEKTIVEBULETINI MUJOR I
SËMUNDSHMERISË
INFEKTIVE
(Pasqyra 14 Sh)

MAJ, 2022

Buletini Muja i Sëmundshmërisë Infektive publikohet çdo muaj nga “Sektori i Survejancës dhe Shërbimi i Inteligjencës Epidemike”, Instituti i Shëndetit Publik (ISHP). Ky Buletin Muja bazohet në të dhënat e Sistemit Madhor të Bazuar në Sëmundje (SMBS) të raportuara përmes Pasqyrës Mujore 14 Sh. Ai plotësohet në Pasqyrë në formatin EXCEL, dhe dërgohet me postë elektronike dhe me postë zyrtare, brenda datës 10 të çdo muaji, në Departamentin e Epidemiologjisë dhe Kontrollit të Sëmundjeve Infektive (DEKSI), Instituti i Shëndetit Publik. Të dhënat e agreguara të Pasqyrës 14 Sh për muajin maj 2022 janë të dhënat e raportuara nga Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH) në rrethe.

1. Sëmundjet diarreike

Sëmundjet diarreike, gjatë muajit maj 2022, zënë 30.6 % të totalit të sëmundjeve infektive të raportuara me anë të Pasqyrës 14 Sh, dhe paraqesin një incidencë 155.0/100.000 banorë. Gastroenteritet e paspecifikuara janë të shpërndara në të gjitha rrethet e vendit dhe zënë peshën kryesore në grupin e sëmundjeve diarreike. Ndërkohë që, në nivel kombëtar helmimet ushqimore paraqesin një incidencë 1.3/100.000 banorë. Rrethet Bulqizë dhe Kukës, mbajnë peshën kryesore në raportimin e helmimeve ushqimore. Duhet theksuar që, numri i lartë i rasteve të raportuara me helmime ushqimore dhe gastroenterite është i lidhur me pamundësinë në nivelin e disa rretheve të diagnozës së saktë klinike, dhe konfirmimit të saj me diagnozën laboratorike mikrobiologjike.

NJVKSH Shkodër mban peshën kryesore të incidencës së Salmonelozës dhe Shigelozës për muajin maj 2022 në nivel kombëtar përkatësisht, 7 raste të konfirmuara me Salmonelozë jo-tifoide dhe 24 raste të konfirmuara me Shigelozë.

Tabela 1: Frekuencat dhe incidencat e sëmundjeve diarreike për muajin maj 2022
(Incidenca raste/100.000 banorë)

	Raste maj 2022	Incidenca maj 2022 (raste/100.000 banorë)
Tifo abdominale + Paratifo	0	0
Salmoneloza	8	0.3
Shigelozë (Disenteri bacilare)	24	0.8
Dizenteri amebike	47	1.6
Toksikoinfeksione alimentare	38	1.3
Gastroenterite (etiologji e panjohur)	4320	150.9
Sëmundje diarreike në total	4437	155.0

2. Tuberkulozi pulmonar

Gjatë muajit maj 2022 janë raportuar 16 raste me TB pulmonar dhe asnjë rast me TB ekstrapulmonar. Nga 16 rastet e raportuara me TB pulmonar, 14 janë të konfirmuara dhe me sputum pozitiv. Rastet pulmonare janë përkatësisht: 6 në Tiranë, 4 në Durrës, 2 në Vlorë, 1 në Fier, 1 në Elbasan dhe në Pogradec, dhe 1 rast në Shkodër. Për të gjitha rastet janë lajmëruar dispanseritë përkatëse për të komunikuar me familjarët e tyre, si dhe për të kryer kontrollin në vatër bazuar në të gjitha ekzaminimet për depistimin e tyre. Të gjithë pacientët kanë filluar mjekimin sipas skemës përkatëse. Siç vihet re dhe nga shpërndarja e rasteve, ato me TB janë të

fokusuara kryesisht në Tiranë me numër më të madh, por në shtrirje rastet janë pothuasje në gjithë vendin. Bashkëpunimi me epidemiologun në rreth, me mjekun e familjes dhe pneumologun duhet të përforcohet më shumë për kontrollin e TB-së në rrethet përkatëse.

3. Sëmundjet zoonotike

Tabela 2. Shpërndarja e zoonozave në muajin maj 2022, numri total i rasteve dhe incidenca (Antraks, Brucelozë, Leptospirozë, Rikecie).

	Maj (Raste 2022)	Incidenca (raste/100,000) 2022
Antraks (Plasje)	0	0
Brucelozë	1	0.03
Leptospirozë	0	0
Rikecie	0	0

Incidenca e Brucelozës në nivel vendi është 0.03/100.000 banorë. Për muajin maj është raportuar 1 rast Bruceloze, i konfirmuar nga NJVKSH Librazhd.


4. Hepatitet virale

Në raportimin mujor të sëmundshmërisë infektive gjatë muajit maj 2022 janë raportuar në total 21 raste me hepatite virale akute (Incidenca 0.73/100.000 banorë) nga të cilat, 18 raste (Incidenca 0.62/100.000 banorë) janë Hepatit viral B (HBV) dhe 3 raste (Incidenca 0.1/100.000 banorë) janë Hepatite virale C (HCV).

Rastet me HBV i përkasin bashkisë Tiranë (15 raste) dhe bashkisë Durrës, Elbasan, Kuçovë me nga një rast secila.


Numri më i lartë i rasteve i përket grup-moshës 50-54 vjeç me 4 raste. (Graf 1, 2)

Grafiku 1. Shpërndarja e rasteve me HBV sipas grup-moshës, maj 2022



Vihet re mungesa e rasteve në grup-moshën pediatrike dhe kjo për shkak të vaksinimit ndaj HBV-së që në 24 orët e para të lindjes.

Grafiku 2. Përqindja e rasteve me HBV sipas grup-moshës, maj 2022



Numri më i lartë i rasteve i përket grup-moshës 50-54vjeç (22.2%).

Rastet me HCV i përkasin bashkisë Tiranë (3 raste). Edhe këto raste janë të shpërndara në grup-moshat aktive, nuk ka raste në grup-mosha pediatrike.

5. HIV/AIDS

Gjatë muajit maj 2022 janë kryer 32 ekzaminime (20 meshkuj dhe 12 femra) për HIV prej të cilave 3 raste (3 meshkuj) kanë rezultuar HIV pozitiv. Shpërndarja gjeografike e rasteve që kanë rezultuar HIV pozitiv është: Tiranë 3 raste. Për sa i përket shpërndarjes sipas grup-moshave: 1 rast i përket grup-moshës 25-34 vjeç, 1 rast grup-moshës 34-45 vjeç dhe 1 rast i përket grup-moshës 45-54 vjeç. Rastet e dyshuara kanë ardhur 1 rast referuar nga një laborator privat (ALNET), 1 rast është referuar nga Shërbimi Infektiv pranë QSUT dhe 1 rast është konfirmuar më parë në Itali.

6. Sëmundje të transmetueshme nga vektorët

Në raportimin mujor të sëmundshmërisë infektive gjatë muajit maj 2022 është raportuar 1 rast i konfirmuar në Laboratorin e Virologjisë pranë ISHP-së, me Ethe Hemoragjike Virale CCHF. Rasti është i grup-moshës 40-44, mashkull, efektiv policie, banues në fshatin Bardhoc, bashkia Kukës. Rasti u paraqit me shenjat klinike pranë Shërbimit Infektiv, QSUT. Nga hetimi epidemiologjik në vatër nga ana e shërbimit epidemiologjik dhe mjedisor pranë NJVKSH-së Kukës, rezultoi se:

Kjo është një vatër e njohur endemike për ethe hemoragjike dhe prani e vektorit transmetues.

U evidentuan kontaktet e ngushta të rastit.

U morën mostra serike të kontakteve dhe u dërguan pranë ISHP-së.

U kontaktua mjeku i zonës dhe u vendos survejanca aktive për çdo rast me shenja të ngjashme.

Testimi laboratorik i 5 kontakteve të ngushta rezultoi negative për anti-CCHF IgM , IgG.

Situata është në monitorim të vazhdueshëm.

INSTITUTI I
SHËNDETIT
PUBLIK

DEKSI